



REPUBLIKAE SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 04, DATË 31, 01, 2024

PËR “MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT DHE SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR MBI PROGRAMIN E BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND PËR VITIN 2024”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 21, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreut IV, pika 1, të vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, të Këshillit, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën Ekonomike 6 për qind, si më poshtë:
 - 1.1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
 - 1.2. Do të përzgjidhen ata aplikues që kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni.
 - 1.3 Prioritet do të kenë familjet me nevoja social-ekonomike të theksuar:
 - a. familje me më shumë se 4 (katër) anëtarë,
 - b. familje me 1 (një) anëtar,
 - c. vajza/gra kryefamiljare të divorcuara/të veja me fëmijë në ngarkim,
 - d. kryefamiljar që me vendim gjykatë kanë në ngarkim fëmijë të mitur,
 - e. Kryefamiljar/e me moshë mbi 50 vjeç që rezultojnë të papunë,
 - f. Familje të cilat sigurojnë të ardhura të pamjaftueshme dhe në përbërje të tyre kanë të mitur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore).
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Etleva YZO

KRYETARI I KËSHILLIT
Merita ISARAJ

Adresa: Sheshi “Çeçiz Topulli”, Gjirokastrë, Shqipëri, Tel: ++355 84 26 4103/26 2424/26 3500, Fax: ++355 84 26 3796